



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më ____/____/2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: "Spektri" shpk Fier

Datë 17.05.2019

Procedura e prokurimit: Tender i Hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit : REF-14050-03-18-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i rrugës “Këneta e Mitros”, Zharrëz, Patos**

Afati : 3 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike

[Data[Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☒ oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- Shoqëria “SHKËLQIMI 07” sh.p.k Fier, Rruga Nacionale Ballsh – Fier, me nr. NUIS K68121808W ofron vlerën sipas preventivit 9 000 000 (**nëntë milion) lekë pa TVSH.**
- Shoqëria “ANBI” shpk Fier, me nr. NUIS K02715442R, në bashkëpunim me shoqërinë “2Z KONSTRUKSION” sh.p.k. Fier me nr. NUIS J63229466K ofron vlerën sipas preventivit **10 499 420 (dhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzet) lekë pa TVSH.**
- Shoqëria “KMK sh.p.k Fier, me nr. NUIS L78223801E, në bashkëpunim me shoqërinë “SINDER AB” sh.p.k Tiranë me nr. NUIS K01531003Ë, ofron vlerën sipas preventivit **10 937 800 (dhjetë million e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.**
- Shoqëria “SPEKTRI” sh.p.k Fier, me nr. NUIS J62903555F, ofron vlerën sipas preventivit **12 424 120 (dymbëdhjetë million e katërqind e njëzet e katër mijë e njëqind e njëzet) lekë pa TVSH.**

* * *

Është skualifikuar si mëposhtë:

Adresa: Lagjja “Naftëtari”, Rruga “ Unaza” ,www.bashkiapatos.gov.al

- 1) Shoqëria “SHKËLQIMI 07” sh.p.k Fier, Rruga Nacionale Ballsh – Fier, me nr. NUIS K68121808W kishte mangësi të dokumentave ligjore.

Mangësitë e dokumentave ligjore të shoqërisë Shoqëria “ SHKËLQIMI 07” sh.p.k Fier, janë si më poshtë :

1. Kanë mangësi të dëshmive të mjeteve që kanë në dispozicion për ekzekutimin e kontratës përkatësisht:

-Kërkohen (2 copë) kamioncina 3-5 ton dhe kanë vetëm (1 copë) me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, mjeti me targë AA607DA me kapacitet 1.2 ton nuk është me kapacitetin e kërkuar pasi duke llogaritur Peshën maksimale të autorizuar (pika 23) që është 3500 me zbritjen e Masës së mjetit bosh (pika 24) që është 2270 nuk del kapaciteti i kërkuar por 1.2 ton. Kamioncina AA610DA ka vetëm Peshën maksimale të mjetit që është 7500 dhe nuk ka Masën e mjetit bosh (pika 24) gjithsesi ky mjet nuk ka çertifikatë pronësie dhe nuk është deklaruar në shtojcën 10 mbi disponimin e mjeteve.

-Kërkohen (2 copë) autobot uji mbi 2m³ dhe kanë vetëm (1 copë) me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, u mungon mjeti tjetër.

-Kërkohet (1 copë) autovinc dhe mjeti i tyre me targë AA969TY nuk është me dokumentacionin e kërkuar pasi i mungon çertifikata e pronësisë dhe nuk është deklaruar në shtojcën 10 mbi disponimin e mjeteve.

2. Për realizimin e punimeve kërkohet që shoqëria të ketë të përfshirë në listpagesë për periudhën shkurt 2018 - janar 2019 Ing.Ndertimi, Ing.Gjeodet, Ing.Hidroteknik, Ing.Elektrik të cilët duhet të figurojnë si drejtues teknik të jenë të pajisur me Certifikim të Sigurimit teknik dhe për secilin të paraqitet Diploma, Kontrata e Punës dhe Cv.

-Ing. Gjeodet Adriana Verkaj – i mungon çertifikata e sigurimit teknik

-Ing. Hidroteknik Rrapi Vrekaj – ka lidhur kontratën në mars të 2018 dhe duhet të ishte në listpagesë në shkurt të 2018.

3. Duhet të kenë një mjek ndërmarrje me dokumentacionin përkatës si Liçensë që të jetë e vlefshme, Kontrata e Punës, Cv, dhe libere pune dhe mjekut të tyre Arben Yzeiraj i mungon Cv.

4. Kërkohet të keni të pajisur me leje manovrimi 2 eskavatoristë + 2 automakinistë, keni 2 eskavatoristët dhe një automakinist Skender Pelanaj.

5. Kërkohen 2 pllakashtrues dhe ju mungojnë, skeni asnjë dokument për këta punonjës.

6. Duhet të jeni të pajisur me Certifikatën ISO 45001-2018 Standart për menaxhimin e Shëndetit dhe sigurisë në Punë dhe juve ju mungon kjo çertifikatë.

Për këto arsye ky operatorë skualifikohet.

- 2) Shoqëria “ANBI” shpk Fier, me nr. NUIS K02715442R, në bashkëpunim me shoqërinë “2Z KONSTRUKSION ” sh.p.k. Fier me nr. NUIS J63229466K kishte mangësi të dokumentave ligjore.

Mangësitë e dokumentave ligjore të shoqërisë Shoqëria “ ANBI” sh.p.k Fier, janë si më poshtë :

1. Kërkohet xhiro mesatare vjetore për tre vitet 2016, 2017, dhe 2018 dhe operatori Anbi nuk ka hedhur.

2. Kanë mangësi të dëshmive të mjeteve që kanë në dispozicion për ekzekutimin e kontratës përkatësisht:

-Kërkohen (3 copë) makina transporti vetëshkarkuese 10-20 ton dhe kanë vetëm dy prej tyre pasi mjeti me targë AA137SC i hedhur nga operatori Anbi nuk është te shtojca 10 mbi deklaratën e disponimit të mjeteve. Kamionat e hedhur nga operatori 2Z Konstruktion kanë mangësi dokumentacioni, kamioni me targë AA953DF s’ka çertifikatë pronësie, foto si dhe

çertifikata e transportit është në emër të qiradhënësit Ermal Muhametaj dhe jo në emër të operatorit 2Z Konstruksion. Kamioni AA195NV nuk ka çertifikatë pronësie, foto si dhe çertifikata e transportit është në emër të qiradhënësit të shoqërisë “Real” shpk për llogari të vetë dhe jo në emër të 2Z Konstruksion. Kamioni AA503TO i ka mbaruar polisa për sigurim të detyrueshëm të mjeteve motorrike në datë 02.04.2019 s’ka foto si dhe çertifikata e transportit është në emër të qiradhënësit të shoqërisë “Real” shpk për llogari të vetë dhe jo në emër të 2Z Konstruksion

-Kërkohen (2 copë) kamioncina 3-5 ton dhe të dy operatorëve ju mungon ky mjet pasi mjetet qëkanë hedhur kanë mangësi dokumentacioni. Kamioncina e hedhur nga operatori Anbi AA486NA nuk është me kapacitetin e kërkuar por këtij mjeti i mungon edhe polisa për sigurim të detyrueshëm të mjeteve motorrike si dhe nuk është në shtojcën 10 te deklarata e disponimit të mjeteve. Kamioncina e hedhur nga operatori Anbi FR5014D nuk është me kapacitetin e kërkuar, por këtij mjeti i mungon edhe çertifikata e pronësisë. Kamioncina e hedhur nga operatori 2Z Konstruksion ka mangësi të dokumentacionit pasi i mungon çertifikata e pronësisë dhe çertifikata e transportit.

-Kërkohen (2 copë) Fadroma dhe kanë vetëm një me të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Fadroma e hedhur nga operatori Anbi nuk është e deklaruar në shtojcën 10 mbi disponimin e mjeteve. Skrepi AGMT02 (Fadrom) e hedhur nga operatori 2Z Konstruksion nuk ka foto.

-Kërkohen (1 copë) Autobetoniere dhe nuk kanë asnjë mjet me të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Autobetonieret që ka hedhur 2Z Konstruksion me targë AA669EB i mungon çertifikata e pronësisë dhe fotot. Autobetonieria me targë AA274BE i ka mbaruar polisa për sigurim të detyrueshëm të mjeteve motorrike në datë 23.1.2019 dhe SGS datë 30.12.2018.

-Kërkohet (1copë) Autovinc dhe nuk kanë asnjëmjet me të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Kamioni me vinxh me targë AA341KL hedhur nga operatori Anbi i ka skaduar çertifikata e transportit në datë 11.01.2019. Autovinci me targë AA588DR i hedhur nga 2Z Konstruksion i mungon çertifikata e transportit.

-Kërkohen (2 copë) Autobotë uji mbi 2m3 dhe kanë vetëm një me të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Autoboti me targë AA098EU i hedhur nga operatori Anbi nuk është ne shtojcën 10 te deklarata e disponimit të mjeteve si dhe çertifikata e transportit është në emër të qiradhënësit të Roni Merkaj dhe jo të operatorit Anbi.

-Kërkohet (1 copë) Autobitumatrice dhe të dy operatorët nuk e kanë këtë mjet.

- Të dy operatorët mjetet që kanë në pronësi nuk i kanë të pasqyruara në bilancin e kërkuar të vitit 2018.

3. Për realizimin e punimeve kërkohet që shoqëria të ketë të përfshirë në listpagesë për periudhen shkurt 2018 - janar 2019 - 40 punonjës përfshirë Ing.Ndertimi, Ing.Gjeodet, Ing.Hidroteknik, Ing.Elektrik të cilët duhet tëfigurojnë si drejtues teknik të jenë të pajisur me Certifikim të Sigurimit teknik dhe për secilin të paraqitet Diploma, Kontrata e Punes dhe Cv.

-Të dy operatorëve ju mungon Ing. Hidroteknik (nuk ka asnjëri asnjë dokument të hedhur për këtë punonjës) dhe Ing. Elektrik, pasi Ing.Elektrik Ervin Sina qëështë drejtues teknik tek operatori 2Z konstruksion nuk ka çertifikatë të sigurimit teknik. Gjithashtu në këtë pikë janë kërkuar të jenë 40 punonjës të siguar në periudhën shkurt 2018 – janar 2019 dhe të dy operatorët nuk e realizojnë këtë gjë pasi Operatori Anbi ka 28 punonjës ndërsa Operatori 2Z Konstruksion ka 38 punonjës të siguar për këtë periudhe.

4. Duhet të kenë një mjek ndërmarrje me dokumentacionin përkatës si Licensë që të jetë e vlefshme, Kontrata e Punës, Cv, dhe librezë pune dhe mjeku i hedhur nga operatori Anbi-Myftar Zemanaj nuk ka librezë pune ndërsa mjeku i hedhur nga operatori 2Z Konstruksion – Pavlina Zyto nuk ka cv dhe librezën e punës.

5. Kërkohet të kenë të pajisur me leje manovrimi 2 eskavatoristë + 2 automakinistë, kanë 1 eskavatoristë me dokumentat e kërkuar ndërsa 2 manovratorët e tjerë Artur Cepele dhe Mikail Kola kanë kontrata manovratori dhe dëshmi për manovratorë por nuk kanë dëshminë për

eskavatoristë, automakinistët e kërkuar nuk i kanë pasi automakinisti i hedhur nga operatori Anbi –Axhem Qalliaj nuk ka kontratë pune.

6. Kërkohen 2 elektrikë dhe nuk i kanë me gjithë dokumentacionin e kërkuar. Elektriçisti i hedhur nga operatori Anbi – Shkelqim Ferko nuk ka kontratë pune dhe dëshmi kualifikimi për elektrikë.

-Kërkohen 2 pllakashtrues dhe nuk i kanë me gjithë dokumentacionin e kërkuar. Pllakashtruesi i hedhur nga operatori Anbi – Astrit Zoga nuk ka dëshmi kualifikimi për pllakashtrues si dhe është në listpagesë të muajit prill 2018 dhe jo shkurt 2018 që kërkohet.

Për këto arsye ky operatorë skualifikohet.

- 3) Shoqëria “KMK” sh.p.k Fier, me nr. NUIS L78223801E, në bashkëpunim me shoqërinë “SINDER AB” sh.p.k Tiranë me nr. NUIS K01531003Ëkishte mangësi të dokumentave ligjore.

Mangësitë e dokumentave ligjore të shoqërisë Shoqëria “KMK” sh.p.k Fier, janë si më poshtë :

Në plotësimin e pikës 2.3 Për kapacitetin teknik : nënpika 2.Dëshmitë për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, ka mangësi dokumentacioni të makinerive vetëlëvizëse dhe teknologjike.

Në plotësimin e pikës 2.3 Për kapacitetin teknik : nënpika 3, 4 , 5 dhe 6 nuk plotëson kriterin mbi kapacitetet teknike pasi asnjë nga operatorët ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për plotësimin e këtyre kriterëve, pasi stafi i kërkuar për realizimin e kësaj kontrate nuk është përfshirë në listpagesa sipas afatit të kërkuar në dst.

Duke iu referuar procedurës së lart përmendur, informojmë se ” **Spektri ”shpk Fier** me nr. NUIS **J62903555F me adresë** Fier ,Lagjja Konferenca e Pezes. se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **12 424 120 (dymbëdhjetë million e katërqind e njëzet e katër mijë e njëqind e njëzet) lekë pa TVSH**,pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkise Patos ,zyra e protokoll arshives dokumentat origjinale ose kopje te noterizuara* ,sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, **brenda 5 ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, **procedura do të anulohet**, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 09.05.2019

Ankesa: ka ose jo **NUK KA**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

TITULLARE E AUTORITETIT KONTRAKTOR
Rajmonda BALILAJ

Adresa: Lagjja “Naftëtari”, Rruga “ Unaza” ,www.bashkiapatos.gov.al